



### KONTRATE

(Shitje te kuotave te kapitalit themeltar të shoqerisë  
“D & C PARTNERS” sh.p.k)

Ne Tirane, sot me daten 25.01/2018 (Dymije e tetembedhete), para meje notere Elida Magani, me seli ne Tirane, u nenshkrua Kontrata e shitjes se Kuotave nga palet:

**Shitesi: Edison Drishti**, atesia Xhemil, i dtl.23.02.1961, lindur dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i paisur me Leternjoftimin me nr.024505171 dhe me numer personal G10223120K

**Blerese: Aspasia Drishti**, atesia Spiro, e dtl.29.06.1965, lindur ne Sarande dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e paisur me Leternjoftimin me nr.024511302 dhe me numer personal G55629039B

Te sipershenuarit me vullnetin e tyre te lire redaktuan kete kontrate shitje aksionesh si vijon:

### KUSHTET E KONTRATES NENI 1 OBJEKTI I KONTRATES

Shoqeria “ D & C PARTNERS” sh.p.k është regjistruar si person juridik me vendimin Nr.27778 date 22.05.2002 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne Tirane, Rruga : "Urani Pano", Pallati i Firmes Cani, Kati i 2, Zyra 8, me NIPT K41531001K, me kapital te shoqerise prej 100.000 leke, me ortak:

*Edison Drishti, ortak i vetem, me 1 kuote qe perben 100 % te kapitalit te shoqerise, me vlere nominale 100.000 leke  
me objekt veprimtarie sipas statutit te shoqerise.*

Asambleja e ortakeve e shoqerise “ D & C PARTNERS” sh.p.k, me Vendimin date 25.01.2018 ka vendosur:

-Transferimin me ane te Kontrates se Shitblerjes te nje kuote qe perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise nga ortaku **z.Edison Drishti** ne favor te bashkeshortes se tij **znj.Aspasia Drishti**.

### NENI 2 CMIMI DHE MENYRA E PAGESES

1. Çmimi i shitjes se nje kuote qe perfaqeson 100 % të kapitalit themeltar të shoqerisë është në shumën 100.000 (njqind mije) Leke.
2. Shitësi **z.Edison Drishti** deklaroi se është likujduar plotësisht jashtë zyrës se noterise nga ana e blerëses **znj.Aspasia Drishti**.
3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate konform ligjit shitësi **z.Edison Drishti** humbet pronesine e nje kuote qe perfaqeson 100 % te kapitalit të shoqerise dhe zoterues i saj behet bleresja **znj.Aspasia Drishti**.
4. Mbas realizimit te shitjes se mesiperme, shoqeria behet me 1 ortak te vetem, **znj.Aspasia Drishti**, zoteruese e nje kuote qe perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise.

### NENI 3

#### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE

- 3.1. Shitesi deklaron se ne daten e nenshkrimit të kësaj kontrate, kuotat objekt shitje jane të lira nga çdo barrë dhe detyrim.
- 3.2. Bleresja merr persiper dhe shitesi i jep te drejte te beje regjistrimin e kesaj kontrate ne Qendren Kombetare te Biznesit.
- 3.3. Shpenzimet e regjistrimit te kesaj kontrate jane ne ngarkim të blereses.


### NENI 4

#### DISPOZITE E FUNDIT

- 4.1. Mosmarrveshjet qe mund te lindin ndermjet paleve do te zgjidhen ne mirekuptim, ne rast te kundert sejcila pale ne kontrate ka te drejte ti drejtohet per kompetence Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane per zgjidhjen e mosmarrveshjeve.
- 4.2. Kontrata redaktohet ne kater kopje origjinale konform rregullave dhe ligjes dhe me vullnet te lire nenshkruhet nga palet e kontrates, dhe vertetohet nga une noteri me vulen dhe nenshkrimin tim.

SHITESI

EDISON DRISHTI



PALET

BLERESE

Aspasia Drishti



NOTERE

Elida Magani

